



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 22.05.2023

Nr: 121

Ora: 13:05

**VENDIM**

**PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 65, PARAQITUR NË KQZ NË DATËN  
20.05.2023**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 22.05.2023, me pjesëmarrjen e:

**Elvin LAKO** - **Relator**

**Ilirjan RUSMALI** - **Anëtar**

**Ledio BRAHO** - **Anëtar**

Shqyrtoi çështjen me:

**ANKUES:** Subjekti zgjedhor “Partia Lëvizja e Legalitetit”, përfaqësuar nga z.  
Shpëtim Axhani

**OBJEKT:** Kundërshtimi i vendimit nr. 325, datë 17.05.2023 të KZAZ nr. 19 “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e këshillit të bashkisë Dibër”.

**BAZË LIGJORE:** Nenet 21/c, 123/1, 124/1, 126, 129, 130 dhe 131 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

#### **VËREN:**

Subjekti zgjedhor “Partia Lëvizja e Legalitetit”, përfaqësuar nga z. Shpëtim Axhani ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 65 regi., datë 20.05.2023.

Në mbledhjen e datës 22.05.2023, ora 13:05, pas relatimit të z. Elvin Lako, u konstatua se kërkesa ankimore nr. 65 i plotësonte elementet e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

#### **V E N D O S I:**

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës nr. 65, datë 20.05.2023 të paraqitur nga subjekti zgjedhor “Partia Lëvizja e Legalitetit”.
2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 23.05.2023 ora 12:30.

3. Ngarkohet administrata e KQZ-së me njoftimin e këtij vendimi palëve në mungesë dhe me zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe përfundon me çeljen e seancës së shqyrtimit në themel, sipas shkronjës “b”, të nenit 68 të Kodit të Procedurave Administrative.

**Elvin LAKO** - **Relator**

**Ilirjan RUSMALI** - **Anëtar**

**Ledio BRAHO** - **Anëtar**